

VENDIM
Nr.24, datë 12.04.2006

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 13, pika 1, germa d të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.26, datë 13.5.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s,” ndryshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.25, datë 27.5.2005, neni 11, germa A, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 12.4.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “G.S.A” sh.p.k., për licencimin e aktivitetit të eksportit të energjisë elektrike,

VENDOSI :

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës, për licencimin e shoqërisë “G.S.A” sh.p.k. për aktivitetin e eksportit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit, si dhe Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun, për shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga shoqëria “G.S.A” sh.p.k., konform rregullores për procedurat e licencimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjeter Dema